



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA



**Raporti nga procesi i organizimit të dëgjimeve buxhetore për
projekt buxhetin e komunës për vitin 2023**

Shtator, 2022

Hyrje

Sipas Qarkores së dytë buxhetore nr.2023/02 për Komuna të datës 16.08.2022 dhe në bazë të shënimeve statistikore të regjistrimit të fundit të popullsisë së Kosovës të vitit 2011, rrjedhë se komuna e Gjakovës ka 94,556 banorë, dhe nga Komisioni i Granteve – MF për vitin 2023 Komunës sonë iu është ndarë Grant Qeveritar 31,558,931.00€.

Tabela nr. 1. Krahassimi i Buxhetit 2022/2023

Nr.	Përshkrimi	Vlera
	Buxheti komunal 2022 (aktual)	27,816,931.00
	Buxheti i propozuar 2023	31,558,423.00
?	Ndryshimi	+3,741,492.00

Burimi: Qarkorja Buxhetore 2023/02, MF 2022

BUXHETI KOMUNAL PËR VITIN 2023

Bazuar në tabelat e buxhetit komunal nga vitet e kaluara dhe me qëllim të vazhdimin të reformave të procesit buxhetor, buxheti komunal për vitin 2023 është planifikuar dhe pasqyrohet sipas strukturës bazë të programeve dhe nën-programeve buxhetore. Për të përmirësuar gjithë-përfshirjen, transparencën dhe kredibilitetin e formulimit të buxhetit komunal, synohet që hartimi i buxhetit të ndërtohet në përputhje me dispozitat e Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal dhe Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP).

Prioritet për financim kanë projektet që janë të vazhdueshme që kanë filluar në vitet e mëparshme dhe atyre që janë në harmoni me prioritetet e Komunës.

Burimet e financimit komunal për vitin 2023

Financimi komunal përfshinë: grantet specifike operative për arsim para universitar dhe shëndetësi primare, grantet për kompetencat e shtuara, të hyrat vetanake të komunave, transferet për kompetencat e deleguara, grantet e jashtëzakonshme, ndihma financiare nga jashtë. Ndërsa, aspekti i huamarrjes së komunave do të jetë si opsion i mundshëm i financimit që është paraparë në ligjin përkatës dhe në kuadër të rregullës fiskale të përcaktuar në LMFPP të dakorduar me Misionin e FMN-së.

Të gjitha të hyrat nga burimet në vijim janë të hyra vetanake të komunës: tatimi në pronë, taksat komunale, gjobat, tarifat dhe pagesat në pajtim me autoritetin që u është dhënë komunave me LFPL.


Sipas Qarkores se parë dhe te dyte buxhetore të lëshuar nga ana e MF-it për periudhën 2023-2025 për Komunën e Gjakovës është caktuar për financimin e shpenzimeve 3 vjeçare si në tabelën 2.

Tabela nr.2. Totali i Burimeve te financimit komunal për vitet: **2022-2025**

Kategoritë BUXHETORE - Burimet e financimit		2022	2023	2024	2025
		Aktual	Vlerësuar	Vlerësuar	Vlerësuar
1	Granti i Përgjithshëm	9,989,347.00	13,219,265.00	14,181,223.00	15,122,235.00
2	Granti specifik i Arsimit	10,437,015.00	10,391,073.00	11,088,840.00	11,131,022.00
3	Granti specifik i Shëndetësisë	3,283,258.00	3,467,988.00	3,641,387.00	3,823,457.00
	Financimi për shërbimet rezidenciale		160,000.00	175,000.00	175,000.00
4	Të hyrat vetanake komunale	3,991,001.00	4,203,787.00	4,361,287.00	4,534,565.00
5	Financimi për teatro	116,310.00	116,310.00	116,310.00	116,310.00
TOTALI:		27,816,931.00	31,558,423.00	33,564,047.00	34,902,589.00


Burimi: Qarkorja Buxhetore 2023/02, MF 2022

Grafiku i trendit të buxhetit komunal 2022-2025



Burimi: Qarkorja Buxhetore 2023/02, MF 2022

Grafiku i buxhetit komunal sipas burimeve të financimit 2023-2025



Burimi:
Qarkorja

Buxhetore 2023/01, MF 2022

Parashikimi i të hyrave vetanake komunale 2023-2025

Përveç Granteve të marra nga niveli qendror, për qëllimet e mbulimit të shpenzimeve të përgjithshme, Komuna mbledh edhe të hyra vetanake. Të hyrat vetanake në Komunën e Gjakovës realizohen në bazë të Rregullores mbi Tarifat dhe Ngarkesat Komunale, Rregullores mbi Tatimin në Pronë si dhe dispozitave tjera ligjore të cilat përcaktojnë llojet e ndryshme të hyrave komunale me të cilat komuna ka të drejtë të caktoj dhe inkasoj siç janë licencat e bizneseve dhe të hyrat tjera vetanake komunale.

Bazën e të hyrave komunale e përbëjnë Tatimi në pronë të cilat të hyra duhet shpenzuar ekskluzivisht në sferën e projekteve për investime kapitale në infrastrukturën rrugore, ujësjellës, kanalizim etj.

Me Qarkoren buxhetore nr. 2022/01, për komunën e Gjakovës, për vitet: 2023 – 2025 është përcaktuar Planin i të hyrave vetanake si vijon:

- Viti 2023 4,203,786.00 €,
- Viti 2024 4,361,287.00 €,
- Viti 2025 4,534,565.00 €.

Drejtoria për Buxhet dhe Financa në përputhje me Ligjin e Menaxhimit të Financave Publike, Ligjin për Buxhet të Republikës së Kosovës dhe Qarkoreve Buxhetore 2023 - 01/02 të pranuar nga Ministria e Financave, Komuna e Gjakovës konkretisht Drejtoria për Buxhet dhe Financa në bashkëpunim me Kuvendin Komunal nga data 18.08.2022 deri me datën 25.08.2022 kanë organizuar Dëgjimet Buxhetore Komunale lidhur me Buxhetin e vitit 2023 dhe dy vitet pasuese.

Në harmoni me dëgjimet ee mbajtura, grupi punues – Sektori i Buxhetit Komunal ka hartuar raportin e dëgjimeve buxhetore, duke ofruar këtu përgjigje për secilën kërkesë të drejtuar nga qytetarët pjesëmarrës në këto dëgjime.

Ecuria e procesit të dëgjimeve buxhetore për projekt buxhetin e vitit 2023

Në këto dëgjime në total kanë qenë gjithsej rreth 183 pjesëmarrës, ku ashtu si edhe vitet e kaluara gjinia dominuese kanë qenë meshkuj

Tregon edhe procesin e organizimit të dëgjimit buxhetor për projekt buxhetin, metodat që janë shfrytëzuar për të konsultuar qytetarët (ueb faqe dhe në platformën e konsultimit publik në nivel qendror), regon për mundësitë që i janë dhënë qytetarëve me dhanë kërkesa /sugjerime për projekt buxhetin e komunës 2023 .

Metodat e konsultimit	Data / Kohëzgjatja	Numri i pjesëmarrësve	Numri i atyre që kanë dhënë komente, kërkesa / sugjerime
1. Takime i drejtpërdrejtë në fshatin BEC	18.08.2022, 1 orë e 30 minuta	17 pjesëmarrës	3 pjesëmarrës kanë parashtruar kërkesa
2. Takim i drejtpërdrejtë në fshatin CËRMJAN	18.08.2022, 1 orë e 30 minuta	23 pjesëmarrës	8 pjesëmarrës kanë parashtruar kërkesa
3. Takim i drejtpërdrejtë në fshatin ROGOVË	19.08.2022, 1 orë e 30 minuta	19 pjesëmarrës	2 pjesëmarrës kanë parashtruar kërkesa
4. Takim i drejtpërdrejtë në fshatin BISHTAZHIN	19.08.2022, 1 orë e 30 minuta	15 pjesëmarrës	4 pjesëmarrës kanë parashtruar kërkesa
5. Takim i drejtpërdrejtë në fshatin PONOSHEC	22.08.2022, 1 orë e 30 minuta	16 pjesëmarrës	5 pjesëmarrës kanë parashtruar kërkesa
6. Takim i drejtpërdrejtë në fshatin SHEREHMET	22.08.2022, 1 orë e 30 minuta	15 pjesëmarrës	2 pjesëmarrës kanë parashtruar kërkesa

7. Takim i drejtpërdrejtë në fshatin NOVOSELLË	23.08.2022, 1 orë e 30 minuta	16 pjesëmarrës	3 pjesëmarrës kanë parashtruar kërkesa
8. Takim i drejtpërdrejtë në fshatin SKIVJAN	23.08.2022, 30 minuta	7 pjesëmarrës	Nuk kishte pyetje të parashtruara
9. Takim i drejtpërdrejtë me OSHC, OJQ, Perfaqësues së grupeve të Intereseve	24.08.2022, 2 orë	28 pjesëmarrës	6 pjesëmarrës kanë parashtruar kërkesa
10. Takim i drejtpërdrejtë përmbyllës me qytetarët	25.08.2022, 2 orë	20 pjesëmarrës	4 pjesëmarrës kanë parashtruar kërkesa

Të gjitha kërkesat e parashtruara në takimet fizikë si dhe ato në formë elektronike, janë shqyrtuar nga Grupi Punues, ndërsa raporti i detajuar për kërkesat e pranuar apo refuzuara, është paraqitur në formë të plotë në shtojcën nr. 1 të këtij raporti.

Projekt buxheti i vitit 2023, pas përmbylljes së procesit të dëgjimeve buxhetore, do të finalizohet dhe deri më **1 shtator 2022** do të procedohet për në kuvendin e Komunës së Gjakovës.

Shtojca – Tabela e detajuar me informatat për kërkesat e dhëna, arsyetimet për kërkesat e pranuar dhe të refuzuara.

Temat e dëgjimit buxhetor	Kërkesat / Sugjerimet / Komentet	Kush ka dhënë kërkesë / sugjerim për projekt buxhetin e vitit 2023	Statusi i kërkesës / sugjerimi (i pranuar , pjesërisht e pranuar apo nuk është pranuar	Arsyetimi (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mos pranimin te komenteve është i detyrueshëm)
Projekt buxheti i vitit 2023	Ndërtimi i kanalizimit ku mbi 70% të banorëve të kësaj bashkësie Lokale janë të pa kyqur në kanalizimin e ujërave të zeza andaj për ne prioritet është ky projekt. kemi edhe disa rrugë të lagjeve si më prioritete janë rruga e lagjes Prenkaj dhe Ndoja në fshatin Zhdrellë , gjithashtu edhe ndriçimi Publik është jashtë funksionit . Poashtu kemi nevojë që në objektin e ambulantes të kemi një renovim të objektit.	Shkelzen Maxhuni: – banorë i fshatit Bec	Pranohet	Përgjigja: Grupi punues pas shqyrtimit dhe analizimit të kërkesës, mbi bazën e mundësive buxhetore dhe shpërndarjes së buxhetit në mënyrë sa më racionale, ka marrë për bazë dhe ka inkorporuar pjesërisht kërkesën e tillë në projeksionet buxhetore të vitit 2023, qështja e kanalizimit do të trajtohet në mërrveshjen me KFË për trajtimin e ujërave të zeza dhe atmosferike, rrugët e fshatit Bec gjithashtu janë përfshirë në project buxhetin e vitit 2023. Poashtu ndriçimi public është përfshirë në buxhetin e vitit 2023 ashtu sikurse edhe renovimi I objekteve egzistuese të mjekësisë familjare.
	Kanalizimin e fshatit i cili është punuar më herët nga Komuna por është punuar në një cilësi të dobët ku tani ka probleme, kanalizimi është bllokuar dhe ujërat e zeza kanë dalë nga kanalizimi mbi rrugë dhe po kundërmojnë që po na shkaktojnë probleme për banorët e kësaj lagje.	Beq Musa - banorë i fshatit Bec	Pranohet	Grupi punues pas shqyrtimit dhe analizimit të kërkesës, mbi bazën e mundësive buxhetore dhe shpërndarjes së buxhetit në mënyrë sa më racionale, ka marrë për bazë dhe ka inkorporuar kërkesën e tillë në projeksionet buxhetore të vitit 2023, qështja e kanalizimit do të trajtohet

				në mërrvëshjen me KFË për trajtimin e ujërave të zeza dhe atmosferike.
	Kërkesa ime është ndërtimi i rrugës Qun Jaki e cila është përafërsisht 350 metra dhe jetojnë mbi 10 familje. Gjithashtu dua ta ngris çështjen e deponis së mbeturinave inerte që janë grumbulluar në afërsi të rrugës.	Pjetër Bala – banorë i fshatit Bec	Pranohet pjesërisht	Grupi punues pas shqyrtimit dhe analizimit të kërkesës, mbi bazën e mundësive buxhetore dhe shpërndarjes së buxhetit në mënyrë sa më racionale, ka marrë për bazë dhe ka inkorporuar pjesërisht kërkesën e tillë në projeksionet buxhetore të vitit 2023, rrugët e fshatit Bec gjithashtu janë përfshirë në project buxhetin e vitit 2023. Lidhur me deponinë e mbeturinave do interesohemi lidhur me gjetjen e lokacionit.
	Ndriçimi Publik mbi 80% nuk punon , Rrugët Lokale në fshat nuk janë përfunduar , Kanali i ujitje së tokave janë edhe 1000 metra që nuk janë përfunduar, mjeku në ambulanten e fshati nuk punon, në shkollë mungon një depo për pelet dhe po na shkakton shumë probleme, gjithashtu rruga kryesore që lidhe fshatin Jabllanic me fshatin Kralan që sa vite nuk është përfunduar dhe nxënësit e Shkollës kanë shumë probleme për të shkuar në shkollë ku gjatë stinës së verës nuk kemi mundësi as dritaret me i hap nga pluhuri që shkaktohet kur kalojnë makinat në atë rrugë. Në këtë shkollë ku jemi po e shihni edhe vet mungon një parking për vetura si dhe trotuari, Është premtuar ndërtimi i një qerdhe në Dushkajë dhe ende nuk është bërë	Hysen Brahimiaj: banorë i fshatit Shqiponjë	Pjesërisht pranohet	Grupi punues pas shqyrtimit dhe analizimit të kërkesës, mbi bazën e mundësive buxhetore dhe shpërndarjes së buxhetit në mënyrë sa më racionale, ka marrë për bazë dhe ka inkorporuar pjesërisht kërkesën e tillë në projeksionet buxhetore të vitit 2023, ndriçimi public është përfshirë në buxhetin e vitit 2023, poashtu ndertimi asfaltimi i rrugeve ne fshatrat Jabllanic, Gergoc, Zhabel, Bardhaniq është i përfshirë në buxhetin e vitit 2023. Pajimet dhe Sinjalizimi i trafikut rrugorë gjithashtu është i përfshirë në project

	as një veprim, deri në fshatin Gërgoc kanë ardhë me shenjëzimin e rrugës dhe me mbylljen e gropave por është ndërprerë aty dhe nuk ka vazhduar deri në fshatrat tjera pse ka ndodh kjo dhe kërkojmë që të kryhen këto projekte që janë prioritete për banorët e Dushkajës.			buxhetin e vitit 2023 ashtu sikurse rehabilitimi i rrugëve me asfalt - sanimi i gropave.
	Prioritet i banorëve të kësaj ane është kanalizimi i ujërave të zeza në fshatin Kodrali, Rruga në fshatin Rashkoc që ka mbetur pa mur mbrojtës dhe po rrezikohen shtëpitë në fshatin Rashkoc nga shembja, i kemi edhe disa rrugë të lagjeve Ukshini, Smajli në Kodrali dhe Agaj në Rashkoc, gjithashtu ndriçimi publik nuk funksionon qe një vit .	Mehemet Rama – banorë i fshatit Kodrali	Pranohet	Grupi punues pas shqyrtimit dhe analizimit të kërkesës, mbi bazën e mundësive buxhetore dhe shpërndarjes së buxhetit në mënyrë sa më racionale, ka marrë për bazë dhe ka inkorporuar kërkesën e tillë në projeksionet buxhetore të vitit 2023, qështja e kanalizimit do të trajtohet në mërrveshjen me KFË për trajtimin e ujërave të zeza dhe atmosferike, poashtu edhe dy problemet tuaja do trajtohen me projektet zgjerimi i linjes se ndriqimit public dhe ndërtimi - sanimi i rrugëve dhe trotuareve me kubëza.
	Kërkesë primare është trotuari nga lagjja e Ukshinëve e deri në Kodrali sepse po rrezikohen banorët dhe sidomos nëxënsit që vijnë në këtë shkollë pra është shumë i nevojshëm ndërtimi i trotuarit, gjithashtu e kemi edhe një rrugë fushore që duhet të intervenohet ku 90% e punëve në bujqësi duhet të kalojnë nëpër atë rrugë e cila është e dëmtuar shumë dhe është vështirë e kalueshme .	Dem Regjepi banorë i fshatit Kodrali	Pranohet pjesërisht	Grupi punues pas shqyrtimit dhe analizimit të kërkesës, mbi bazën e mundësive buxhetore dhe shpërndarjes së buxhetit në mënyrë sa më racionale, ka marrë për bazë dhe ka inkorporuar pjesërisht kërkesën e tillë në projeksionet buxhetore të vitit 2023, problemi juaj do trajtohet në projektin ndërtimi - sanimi i rrugëve

				dhe trotuareve me kubëza si dhe në projektin ndërtimi - rregullimi i rrugëve fushore, projekte që janë përfshinë në projekt buxhetin e vitit 2023.
	Fillimisht ju falënderoj që është bërë realizimi i projektit kanalizimit të ujërave të zeza por banorët e këtushëm kanë nevojë edhe për disa projekt tjera si tek rruga e lagjes së Hasjanëve e cila është në gjatësi 1000 metra dhe është në një gjendje të keqe pra atje jetojnë një lagje e tërë dhe rruga është pothuajse e pa kalueshme kërkojmë që të përfshihet në buxhetin e vitit 2023, gjithashtu rruga tek varrezat është një gjatësi të vogël përafërsisht 100 metra, rruga kryesore e fshatit është një gjatësi 5 Km dhe është dëmtuar mjaft shumë andaj kërkohet një intervenim emergjent që të riparohen ato gropa dhe të bëhet e kalueshme, kërkesa tjetër është ndërtimi i trotuareve. Shqetësim i banorëve të këtushëm është edhe ndërprerje e shpeshtë e rrymës që po na shkakton shumë probleme në ekonominë familjare dhe në të gjitha aspektet e jetës së banorëve të Dushkajës.	Rahman Kida - banorë I fshatit Cërmjan	Pranohet pjesërisht	Grupi punues pas shqyrtimit dhe analizimit të kërkesës, mbi bazën e mundësive buxhetore dhe shpërndarjes së buxhetit në mënyrë sa më racionale, ka marrë për bazë dhe ka inkorporuar pjesërisht kërkesën e tillë në projeksionet buxhetore të vitit 2023, shqetësimi juaj për rrugën do të trajtohet në projektin e vitit 2023 ndërtimi - asfaltimi i rrugëve në fshatrat Cërmjan, Meqë, gjithashtu edhe trotuaret do të trajtohen në projektin ndërtimi - Sanimi i rrugëve dhe trotuareve me kubëza.
	Kryetari i Komunës na ka premtuar për ndërtimin e një rrethrotullimi aty në qendër të fshatit tek kryqëzimi i rrugëve si dhe ka premtuar një lapidar të dëshmorëve andaj kërkoj që të përfshihen edhe realizimi i këtyre dy projekteve që janë shumë të rëndësishme për banorët e fshatit Cërmjan.	Labinot Kurhasku – banorë I fshatit Cërmjan	Pranohet pjesërisht	Grupi punues pas shqyrtimit dhe analizimit të kërkesës, mbi bazën e mundësive buxhetore dhe shpërndarjes së buxhetit në mënyrë sa më racionale, do shqyrtoj mundësinë e zgjidhjes së shqetësimit tuaj. Lidhur me lapidarin e dëshmorit kërkesa duhet të drejtohet tek Agjencioni për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës për shkak që këto

				objekte janë kompetencë e këtij agjencioni.
	E falënderoj drejtorinë e Shëndetësisë për kompletimin e ambulantës së fshatit Cërmjan me laborator për analiza dhe me të gjitha pajisjet e nevojshme .	Tafil Kokalla – banorë i fshatit Cërmjan	Nuk ka parashtruar kërkesë	
	Fshati Kralan kërkojmë që të bëhet ndërtimi i kanalit të ujitjes së tokave në fshatin Kralan janë ndërtuar 800 metra por kemi nevojë edhe për 2400 metra që të ndërtohen dhe ujiten mbi 30 hektar tokë, gjithashtu kërkojmë zgjerimin e rrugës që na dërgon tek ato toka sepse është shumë e vështirë dhe e pa kalueshme, në ambulanten e fshatit Kralan është një karrige stomatologjike por nuk ka hyrë në funksion asnjëherë andaj kërkojmë që të angazhohet një stomatolog, gjithashtu edhe kanalizimin i ujërave të zeza është kërkesë prioritet e banorëve të fshatit Kralan.	Abdullah Halilaj banorë i fshatit Kralan	Pranohet pjesërisht	Grupi punues pas shqyrtimit dhe analizimit të kërkesës, mbi bazën e mundësive buxhetore dhe shpërndarjes së buxhetit në mënyrë sa më racionale, ka marrë për bazë dhe ka inkorporuar pjesërisht kërkesën e tillë në projeksionet buxhetore të vitit 2023, kanalet e ujitjes do të trajtohen në projektin ndërtimi i kanaleve të ujitjes, edhe zgjerimi i rrugës në projektin ndërtimi - rregullimi i rrugeve fushore, njejtë sikurse qështja e kanalizimit në projektin me bashkëfinancim me donatorë KFË.
	Kërkojmë që për rinin e rajonit të dushkajës të realizohet ndonjë projekt qoftë sportiv apo kulturor sepse nuk kemi asnjë një vend të dedikuar për aktivitete rinore për rinin e Dushkajës, kemi nevojë për ndërtimin e një tereni sportiv me dimenzone 100 metra me 50 për realizimin e aktiviteteve sportive të futbollit sepse ne jemi të detyruar që rinin ti dërgojmë në Gjakovë për zhvillimin e këtyre aktiviteteve sportive .	Idriz Brahimaj – banorë i rajonit të Dushkajës	Pjesërisht pranohet	Grupi punues pas shqyrtimit dhe analizimit të kërkesës, mbi bazën e mundësive buxhetore dhe shpërndarjes së buxhetit në mënyrë sa më racionale, do shqyrtoj mundësinë për gjetjen e lokacionit.

	Ura është shqetësimi kryesor për fshatin Rogovë dhe shumë fshatra tjerë që e frekuentojnë këtë zonë. Problem tjetër kemi me mungesë të kanalizimit dhe kanalit të ujrave atmosferik. Gjithashtu kanë mbetur pa u rregulluar edhe disa rrugë brenda fshatit. Në shumë vende në fshat mungon ose nuk punon ndriqimi publik. Shtëpia e Kulturës ka mbetur e pa përfunduar që nga viti 2018.	Islam Gashi – banorë i fshatit Rogovë	Pranohet	Grupi punues pas shqyrtimit dhe analizimit të kërkesës, mbi bazën e mundësive buxhetore dhe shpërndarjes së buxhetit në mënyrë sa më racionale, problemi i urës na ka shqetësuar edhe ne mirëpo ky është projekt që e ka marr përsipër Ministria e Infrastrukturës. Kanalizimi i ujërave të zeza do trajtohet nga donatorët me të cilët komuna veqëse ka marrëveshje dhe është në proces. Zgjerimi i linjes së ndriqimit publik është projekt që do trajtoj shqetësimin tuaj me ndriqimin publik. Ndërkaq shtëpia e kulturës është në proces vitin aktual.
	Shkolla fillore është pa ngrohje qendrore.	Ilhami Shala – banorë i fshatit Rogovë	Pranohet	Grupi punues pas shqyrtimit dhe analizimit të kërkesës, mbi bazën e mundësive buxhetore dhe shpërndarjes së buxhetit në mënyrë sa më racionale, sistemi i ngrohjes do të trajtohet në marrëveshjen të cilën veqëse e ka lidh Komuna me donatorë.
	Përveq Marmullit, fshatrat tjerë të këtij regjioni nuk kanë kanalizim. Mungesa e kanalizimit po i shkatërron tokat bujqesore.	Tomë Lleshdedaj banorë i fshatit Marmull	Pranohet	Grupi punues pas shqyrtimit dhe analizimit të kërkesës, mbi bazën e mundësive buxhetore dhe shpërndarjes së buxhetit në mënyrë sa më racionale, ka marrë për bazë dhe ka inkorporuar pjesërisht kërkesën e tillë në

				projeksionet buxhetore të vitit 2023, Ministria e Infrastrukturës. Kanalizimi i ujërave të zeza do trajtohet nga donatorët me të cilët komuna veqëse ka marrëveshje dhe është në proces.
	Rruga e nisur ne vitin 2008 nuk ka përfunduar ende.	Pjeter Lleshdedaj banorë i fshatit Bishtazhin	Pranohet, pjesërisht	Grupi punues pas shqyrtimit dhe analizimit të kërkesës, mbi bazën e mundësive buxhetore dhe shpërndarjes së buxhetit në mënyrë sa më racionale, ka marrë për bazë dhe ka inkorporuar pjesërisht kërkesën e tillë në projeksionet buxhetore të vitit 2023, do mundohemi ti shqyrtojmë edhe problemet ligjore që kanë lindur me këtë projekt.
	Rruga Buna – rruga e varrerezave nuk është ndërtuar ende	Gasper Gjuga banorë i fshatit Bishtazhin	Pranohet	Grupi punues pas shqyrtimit dhe analizimit të kërkesës, mbi bazën e mundësive buxhetore dhe shpërndarjes së buxhetit në mënyrë sa më racionale, ka marrë për bazë dhe ka inkorporuar pjesërisht kërkesën e tillë në projeksionet buxhetore të vitit 2023, rruga e potencuar do të trajtohet në projektin ndërtimi - asfaltimi i rrugëve në fshatrat Marmull, Bishtazhin, Fshaj, Kushavec.

	Një rrugë në fshatin Dol është premtuar dhe ende nuk kanë filluar punimet.	Mark Kqinari banorë i fshatit Dol	Pranohet	Grupi punues pas shqyrtimit dhe analizimit të kërkesës, mbi bazën e mundësive buxhetore dhe shpërndarjes së buxhetit në mënyrë sa më racionale, ka marrë për bazë dhe ka inkorporuar pjesërisht kërkesën e tillë në projeksionet buxhetore të vitit 2023, rruga e potencuar do të trajtohet në projektin ndërtimi - asfaltimi i rrugëve në fshatrat Pjetërshan, Kusar, Dol.
	Kërkojmë të asfaltohet Rruga “Ymer Bytyqi” në fshatin Morinë	Musa Ibrahim banorë i fshatit Morinë	Pranohet	Grupi punues pas shqyrtimit dhe analizimit të kërkesës, mbi bazën e mundësive buxhetore dhe shpërndarjes së buxhetit në mënyrë sa më racionale, ka marrë për bazë dhe ka inkorporuar pjesërisht kërkesën e tillë në projeksionet buxhetore të vitit 2023, rruga e potencuar do të trajtohet në projektin ndërtimi - asfaltimi i rrugëve në fshatrat Ponoshec, Morinë, Popoc.
	Kur të nis ndërtimi i shkollës fillore, nxënësit do të kalojnë në objektin e shkollës së mesme. Por nuk ka trotuare për të shkuar në shkollën e mesme. Kërkojmë ndërtimin e trotuareve ose bartjen e nxënësve nga shkolla fillore që do të rrënohet deri në objektin e shkollës së mesme.	Valdet Sadrija banorë i fshatit Ponoshec	Pranohet	Grupi punues pas shqyrtimit dhe analizimit të kërkesës, mbi bazën e mundësive buxhetore dhe shpërndarjes së buxhetit në mënyrë sa më racionale, ka marrë për bazë dhe ka inkorporuar pjesërisht kërkesën e tillë në

				projeksionet buxhetore të vitit 2023, problemi juaj do trajtohet në projektin Ndërtimi - sanimi i rrugëve dhe trotuareve me kubëza.
	Kanalet te ujitjes ne fshatin Brovine dhe disa rrugë në fshat. Gjithashtu mungon edhe ndriçimi publik.	Driton Asllani banorë i fshatit Brovinë	Pranohet	Grupi punues pas shqyrtimit dhe analizimit të kërkesës, mbi bazën e mundësive buxhetore dhe shpërndarjes së buxhetit në mënyrë sa më racionale, ka marrë për bazë dhe ka inkorporuar kërkesën e tillë në projeksionet buxhetore të vitit 2023, problemet tuaja do trajtohen në projektet zgjerimi i linjes se ndriqimit publik, ndërtimi - asfaltimi i rrugëve në fshatrat Molliq, Nivokaz, Brovinë si dhe në projektin e bujqësisë - Ndërtimi i Kanaleve të ujitjes.
	Ndriçimi, kanalet e ujitjes dhe disa rrugica në fshatin Stubëll	Sokol Sadrija banorë i fshatit Stubëll	Pranohet pjesërisht	Grupi punues pas shqyrtimit dhe analizimit të kërkesës, mbi bazën e mundësive buxhetore dhe shpërndarjes së buxhetit në mënyrë sa më racionale, ka marrë për bazë dhe ka inkorporuar pjesërisht kërkesën e tillë në projeksionet buxhetore të vitit 2023, problemet tuaja do trajtohen në projektet zgjerimi i linjes se ndriqimit publik dhe në projektin e bujqësisë - Ndërtimi i Kanaleve të ujitjes.

	Një urë ne përroin Llabenica në fshatin Ponoshec	Drilon Sadrija banorë i fshatit Ponoshec	Pranohet	Grupi punues pas shqyrtimit dhe analizimit të kërkesës, mbi bazën e mundësive buxhetore dhe shpërndarjes së buxhetit në mënyrë sa më racionale, ka marrë për bazë dhe ka inkorporuar pjesërisht kërkesën e tillë në projeksionet buxhetore të vitit 2023, problemi juaj do trajtohet në projektin Ndërtimi dhe sanimi i Urave.
	Mungon Trotuari në Sherehmet e gjithashtu kemi nevojë për më shumë kanale të ujitjes	Agim Ramaj banorë i fshatit Sherehmet	Pranohet	Grupi punues pas shqyrtimit dhe analizimit të kërkesës, mbi bazën e mundësive buxhetore dhe shpërndarjes së buxhetit në mënyrë sa më racionale, ka marrë për bazë dhe ka inkorporuar pjesërisht kërkesën e tillë në projeksionet buxhetore të vitit 2023, problemet tuaja do trajtohen në projektet Ndërtimi - Sanimi i rrugëve dhe trotuareve me kubëza si dhe në projektin e bujqësisë - Ndërtimi i Kanaleve të ujitjes.
	Rruga Madanaj – Rrypaj që 11 vjet është kryer shtresa e parë e asfaltit dhe ka mbetur ashtu. Gjithashtu janë të nevojshme kanalet e ujitjes në fshatrat Rrypaj, Madanaj dhe Jahoc si dhe Penda në fshatin Madanaj.	Zhel Berisha banorë i fshatit Madanaj	Pranohet pjesërisht	Grupi punues pas shqyrtimit dhe analizimit të kërkesës, mbi bazën e mundësive buxhetore dhe shpërndarjes së buxhetit në mënyrë sa më racionale, ka marrë për bazë dhe ka inkorporuar pjesërisht kërkesën e tillë në projeksionet buxhetore të

				vitit 2023, lidhur me rrugën jemi në dijeni dhe do interesohemi për zgjidhje, ndërkaq kanalet e ujitjes do trajtohen në projektin e bujqësisë - Ndërtimi i Kanaleve të ujitjes.
	Një rrugë në fshatin Palabardh. Dy kanalizime. Kanale të ujitjes. Disa rrugica. Nriqimi public. Një shëtitore prej lagjes së Gjokajve deri tek liqeni I Radoniqi.	Mustaf Alijaj banorë i fshatit Palabardh	Pranohet pjesërisht	Grupi punues pas shqyrtimit dhe analizimit të kërkesës, mbi bazën e mundësive buxhetore dhe shpërndarjes së buxhetit në mënyrë sa më racionale, ka marrë për bazë dhe ka inkorporuar kërkesën e tillë në projeksionet buxhetore të vitit 2023, rruga është e paraparë të përfundohet vitin aktual , kanalet e ujitjes do trajtohen në projektin e bujqësisë - Ndërtimi i Kanaleve të ujitjes, ndërkaq për shëtitore do interesohemi.
	Ruga Gjergj Kastrioti ka nevojë për ndriqim. Novosella ka nevojë për kanalizim. Dy rrugica nga 200 metra kanë mbetur pa u përfunduar	Albert Marjakaj banorë i fshatit Novosellë	Pranohet	Grupi punues pas shqyrtimit dhe analizimit të kërkesës, mbi bazën e mundësive buxhetore dhe shpërndarjes së buxhetit në mënyrë sa më racionale, ka marrë për bazë dhe ka inkorporuar kërkesën e tillë në projeksionet buxhetore të vitit 2023, problemet tuaja do trajtohen në projektet zgjerimi i linjes së ndriqimit publik si dhe në projektin rehabilitimi i rrugëve me asfalt.

	Rruga e Biteshit. Në Novosellë ambulanca nuk ka kanalizim.	Robert Marjakaj banorë i fshatit Bitesh	Pranohet	Grupi punues pas shqyrtimit dhe analizimit të kërkesës, mbi bazën e mundësive buxhetore dhe shpërndarjes së buxhetit në mënyrë sa më racionale, ka marrë për bazë dhe ka inkorporuar kërkesën e tillë në projeksionet buxhetore të vitit 2023, problemet tuaja do trajtohen në projektin Ndërtimi - asfaltimi i rrugës në fshatin Bitesh si dhe në projektin Rehabilitimi i ujrave të zeza dhe atmosferike.
	Kërkojme që në këtë projekt buxhet te merrën parasysh kërkesat tona. Të bëhet rregullimi i infrastrukturës për personat me aftësi të kufizuara dhe të verbërve. Gjithashtu të intervenohet edhe ne trotualet, pjerrinat, shirita etj. Te shëndetësia të na mundësohen aparatura akustike Braun për ndëgjim si dhe tensiometër, pulskometër, Sterilizator etj.	Mark Pjetraj – pjestar i komunitetit të qytetarëve me aftësi të kufizuara		Grupi punues pas shqyrtimit dhe analizimit të kërkesës, mbi bazën e mundësive buxhetore dhe shpërndarjes së buxhetit në mënyrë sa më racionale, ka marrë për bazë dhe ka inkorporuar kërkesën e tillë në projeksionet buxhetore të vitit 2023, sa i përket kërkesës suaj për inkorporimin e kërkesave në investime kapitale po ju ri informojmë se qdo projekt që nga viti 2020 e tutje është i paraparë me këto kritere me qëllim të mbështetjes suaj. Paisjet e potencuara do mbulohen nga projekti Blerja e paisjeve mjekësore.
	Sa është Buxheti për Rinin vitin e ardhshëm fiskal, a ka rritje nga viti aktual? A ka mundësi Komuna të ofroj lehtësira për OJQ-të dhe mos ti	Dorina Lluka Davis përfaqësuese e WMCA	Nuk pranohet	Grupi punues pas shqyrtimit dhe analizimit të kërkesës, mbi bazën e mundësive buxhetore dhe

	kushtëzoj ato që të posedojnë fonde në momentin e aplikimit për subvencione. Sepse shumica e organizatave hezitojnë të aplikojnë në momentin që kushtëzohen. Nuk besoj që kjo kërkesë është e pa realizueshme sepse shumica e organizatave nuk i'u ofrojnë të tilla kushtëzime OJQ-ve.			shpërndarjes së buxhetit në mënyrë sa më racionale, nuk ka marrë për bazë dhe nuk ka inkorporuar kërkesën e tillë në projeksionet buxhetore të vitit 2023 duke qenë se Komuna ndanë Subvencione duke rrespektuar rregulloren në fuqi për ndarjen e subvencioneve dhe nuk mund të veprohet ndryshe edhe përkundër vullnetit.
	Buxheti është i vogël për të rinjtë e Komunës. Të ngritet interesimi i të rinjëve, të ofrohet një modulitet i akceptueshëm për të motivuar. A ka paraparë Komuna diçka për Pensionist, duke qenë se janë kategori e njerzve me përvoja të ndryshme jetësore dhe mund të përfitojmë shumë prej tyre.	Berat Thaqi – përfaqësues i organizatave rinore	Pranohet	Grupi punues pas shqyrtimit dhe analizimit të kërkesës, mbi bazën e mundësive buxhetore dhe shpërndarjes së buxhetit në mënyrë sa më racionale, ka marrë për bazë dhe ka inkorporuar kërkesën e tillë në projeksionet buxhetore të vitit 2023, Komuna veqëse është në dijeni për kontributin e kësaj grup moshe dhe veqëse ka paraparë mjete nga kategoritë ekonomike për këta njerëz. Për informacion veqëse është në proces një Qendër ditore rekreative për pensionist
	Deri kur mundem me jap rekomandime për Buxhetin. Cila është shumica e subvencioneve për OJQ-të? A ofron subvencione për rini vetëm dikasteri i Kulturës, Rinis dhe Sportit apo edhe programet tjera buxhetore. A mund të përcjellim me email	Arbër Lleshi i përfaqësues i organizatës rinore	Nuk ka parashtruar kërkesë	Rekomandime mbi buxhetin mund të ofrohen deri fund të shtatorit, konkretisht data e fundit është data 27 shtator, atëherë kur mbahet mbledhja e fundit e

	kërkesat tona konkrete, deri në çfarë afati?.			shtatorit e asamblesë komunale, për shkak që në këtë mbledhje duhet të miratohet buxheti komunal për vitin e ardhshëm fiskal dhe dy vitet pasuese. Subvencione për OJQ ofron kryesisht programi i Kulturës, Rinisë dhe Sportit mirëpo në raste të caktuara edhe zyra e Kryetarit.
	A do të ketë punësim për te verbërit, jo veq nga komuna por edhe nga institucionet tjera shtetore komunale?	Shkumbin Zherka përfaqësues i shoqatës së të verbërve	Pranohet	Grupi punues pas shqyrtimit dhe analizimit të kërkesës, mbi bazën e mundësive buxhetore dhe shpërndarjes së buxhetit në mënyrë sa më racionale, ka marrë për bazë dhe ka inkorporuar kërkesën e tillë në projeksionet buxhetore të vitit 2023, konkurset parashihen edhe për personat me aftësi të kufizuara dhe jemi të thirrur të veprojmë sipas ligjeve në fuqi dhe standarteve të meritokracisë.
	Jam përfaqësues i shurdhmemecëve dhe kërkesa jonë është që të na sigurohet ndonjë fond financues pasi që skemi perfitu asnjëherë edhe pse kemi aplikuar disa herë. Nëse mundet Komuna të na mundësoj të paktën një pagë pasi punojmë që 12 vite si vullnetarë pa pagesë.	Musli Arifi përfaqësues i shoqatës së shurdhmemecëve	Pranohet	Grupi punues pas shqyrtimit dhe analizimit të kërkesës, mbi bazën e mundësive buxhetore dhe shpërndarjes së buxhetit në mënyrë sa më racionale, ka marrë për bazë dhe ka inkorporuar kërkesën e tillë në projeksionet buxhetore të vitit 2023, mjafton të aplikoni për subvencionim.

	Ruga Tirana përballë rrugës Luan Haradinaj, qështja e sigurisë jemi të rrezikuar, nuk është rruga e asfaltuar nuk ka as zhavor, dhe është e tëra në baltë. Kemi probleme me rrymë, sot janë 55 shtepi në atë pjesë. Për tu qasur fëmija në shkollë duhet ti kaloj dy traka tranziti për të shkuar në shkollën Emin Duraku. Javën e kaluar e kam pasur rastin kur më është shkelur prindi nga një motocikletë, rrezikëshmeria është e madhe ju kisha lutë që të merret parasysh si kërkesë, të paktën edhe nëse nuk bëhet një herë asfalt të shtrohet zhavor ose kocka që mos të behen me baltë ose të vendoset ndonjë shenjë që aty është shkolla që të kenë edhe veturat në qarkullim pak konsideratë.	Ilir Krasniqi – përfaqësues i shoqërisë civile	Pranohet	Grupi punues pas shqyrtimit dhe analizimit të kërkesës, mbi bazën e mundësive buxhetore dhe shpërndarjes së buxhetit në mënyrë sa më racionale, ka marrë për bazë dhe ka inkorporuar kërkesën e tillë në projeksionet buxhetore të vitit 2023 kjo rrugë parashihet në projektin Ndërtimi - asfaltimi i rrugëve Petro Nini Luarasi.
	Lagjja jonë ka mbi 50 shtëpi, gjindet në zonën që lidh Rezinën me Qytetin, ka plotë mbeturina, djegja është e vazhdueshme, ka plotë baltë, infrasruktura e dobët rrugore. Si dhe vlenë të ceket që secila shtëpi ka leje urbanisistike, janë tatim pagues të rregulltë, është zonë që nëse e trajton gjeografikisht jemi në qendër të qytetit, kërkojmë të mos anashkalohejmë përderisa Komuna bënë investime tjera në zona ku ka mjaftueshëm investim.	Besnik Morina përfaqësues i shoqërisë civile	Pranohet	Grupi punues pas shqyrtimit dhe analizimit të kërkesës, mbi bazën e mundësive buxhetore dhe shpërndarjes së buxhetit në mënyrë sa më racionale, ka marrë për bazë dhe ka inkorporuar kërkesën e tillë në projeksionet buxhetore të vitit 2023 kjo rrugë parashihet në projektin Ndërtimi - asfaltimi i rrugëve Petro Nini Luarasi
	Përshendetje besojë që po më njihni mirë, i kam përcjell me shkrim projektet besoj se në vitin 2023 shpresoj që të përfundoj sepse është 23 vjetori i asaj Masakre të madhe, thjesht ishte si rikujtim shpresojë që ta trajtoni si kërkesë	Halil Ahmeti - përfaqësues i shoqërisë civile	Pranohet	Grupi punues pas shqyrtimit dhe analizimit të kërkesës, mbi bazën e mundësive buxhetore dhe shpërndarjes së buxhetit në mënyrë sa më racionale, ka marrë për bazë dhe ka inkorporuar kërkesën e tillë në projeksionet buxhetore të vitit 2023 kërkesën tuaj do mundohemi ta mbulojmë në projektin

				Sanimi dhe ndërtimi i parqeve.
	Rruga kryesore në Dol është shume e dëmtuar edhe pse frekuentohet shpesh tani edhe për shkak të Shpellës së Kusarit, a parashihet të bëhet riparimi? Shkolla e vjetër tani shfrytëzohet për narkoman a do bëhet diqka ne atë shkollë?	Kastriot Tahiri – përfaqësues i shoqërisë civile	Pranohet pjesërisht	Grupi punues pas shqyrtimit dhe analizimit të kërkesës, mbi bazën e mundësive buxhetore dhe shpërndarjes së buxhetit në mënyrë sa më racionale, ka marrë për bazë dhe ka inkorporuar kërkesën e tillë në projeksionet buxhetore të vitit 2023 kërkesën tuaj për rrugën do mundohemi ta zgjidhim pasi që ka probleme ligjore.